



Prishtinë: 27.05.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_182\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_217\_05\_09

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_217\_05\_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 25.05.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZHET** ankesa e konsumatorit Ali Demolli (shifra e konsumatorit DPR – 271380) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 29.01.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.04.2009, lidhur me kontestimin e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar.

- Në me datë 16.06.2005 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë hequr njehsorin nr. 30201928 dhe kanë vendosur njehsorin ri nr. 31553185  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit i KEK-ut nr. 003564 të datës 10.03.2008
- Në muajin 04/2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë hequr njehsorin nr. 34553185 dhe kanë vendosur njehsorin ri nr. 40862975  
**Provë:** Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit i KEK-ut nr. 003564 të datës 10.03.2008
- Me datë 22.10.2008 Qendra e Kalibrimit gjatë kontrollimit detal të njehsorit nr. 30210461 ka konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllomb) i ka të manipuluar.  
**Provë:** Procesverbali i Qendrës së Kalibrimit nr11/22 të datës 22.10.2008

- Me datë 19.12.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalur tek konsumatori dhe kanë regjistruar të dhënat teknike të pikës matëse, profilin e kabllit, siguresat etj.  
**Provë:** Procesverballi i KEK-ut nr. 208627 të datës 17.12.2008
- Me datë 06.02.2009 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar sipas faturës DPR09HP07285 në shumë prej 1,223.85  
**Provë:** Fatura DPR09HP07285 të datës 06.02.2009
- Me datë 30.03.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën e shfrytëzimit të paautorizuar.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 22.04.2009 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në proceset e kontrollës dhe procesin e kalibrimin.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 22.04.2009
- Me datë 29.04.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e KEK-ut në DMK të ZRRE-së
- Me datë 14.05.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me kontestimin e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar.  
**Provë:** Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 12.05.2009
- Me datë 25.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_217\_05\_09.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_217\_05\_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluasi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar